



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.428/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rustem Thaqi, Fejzullah Rexhepi, Kymete Kicaj, Zyhdi Haziri, Afijete Sada - Glllogjani, Faton Ademi, Adnan Konushevci dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkritazi me apelin e koalicionit NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), nr.1659-2019 të datës 07.11.2019, me të cilin është shpallur rezultati përfundimtar në të cilin janë përfshirë 3782 pako me fletëvotime nga Republika e Serbisë, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET i bazuar apeli Anr.428/2019 i datës 07.11.2019, i paraqitur nga koalicioni NISMA-AKR-PD, shpallen të pa vlefshme 3782 (tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy) pako me fletëvotime të ardhura nga Republika e Serbisë, të dorëzuara në Postën Nr. 6, në Rrugën “Agim Ramadani” në Prishtinë, **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, votat e përfshira nga fletëvotimet në këto pako, t’i largoj nga rezultati përfundimtar i publikuar me datë 07.11.2019.

A r s y e t i m

Me datën 07.11.2019, PZAP-i ka pranuar apelin Anr.428/2019, të paraqitur nga koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, kundër vendimit të KQZ-së, nr.1659-2019 të datës 07.11.2019, me të cilën pretendon se vendimi në fjalë është në kundërshtim me nenin 97 par. 1 dhe 2 të LZP-së, lidhur me nenet 4.3 dhe 4.4, të Rregullës Zgjedhore Nr.03/2013, sa i përket mënyrës së rregullt të pranimin përmes postës së votuesve individual me të drejtë vote e të cilët jetojnë jashtë Kosovës, duke propozuar që PZAP-i, të aprovojë ankesën në tërësi si të bazuar në pajtim me dispozitat e LZP-së, në fuqi duke i shpallur të parregullta/pavlefshme 3.782 zarfe, pas administrimit të provave t’i anulojë këto pako, të ardhura/bartura nga Serbia, përmes dy personave të paautorizuar nga KQZ-ja, njëri nga të cilët i pa identifikueshëm, në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjore dhe të obligojë KQZ-në, që t’i largoj nga rezultati përfundimtar i shpallur nga KQZ-ja, me datë 07.11.2019. Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se KQZ-ja, ka shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 45 të saj dhe LPZ-në, përkatësisht nenin 3 dhe 97, par. 1 dhe 2, lidhur me nenet 4.3 dhe 4.4, të Rregullës Zgjedhore Nr.03/2013, duke mos i trajtuar të barabartë shtetasit e saj, me të drejtë vote jashtë Kosovës dhe kështu duke përdorur standarde të dyfishta në vlerësimin dhe pranimin e pakove me zarfe nga Serbia, të grumbulluara në mënyrë kolektive dhe të dorëzuara fizikisht në postën nr.6, në Prishtinë, kjo mënyrë e dërgimit të pakove me fletëvotime, nuk parashikohet me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së, apo të Rregullave Zgjedhore në Republikën e Kosovës, ndërsa për shtetasit e tjerë nga vendet tjera të botës mënyra e pranimin të votave është bërë si vota individuale, të dërguara me postë nga vendet ku jetojnë, konform nenit 97 par. 1 dhe 2 të LZP-së, lidhur me nenet 4.3 dhe 4.4, të Rregullës Zgjedhore Nr.03/2013. Më tej, paraqitësi i ankesës ka theksuar se pakot e transportuara

ilegalisht nga persona të paautorizuar nga KQZ-ja, në postën Nr.6 në Prishtinë, nuk kanë vulë dhe as pullë postare të postës së origjinës, se nga cila adresë janë nisur, për tu përputhur adresat personale, për votim individual personal, që do të duhej të ishte ndonjëra nga postat e Serbisë, duke pasur parasysh faktin se votuesit kanë votuar në Serbi, që paraqet shkelje të nenit 4.3, të Rregullës Zgjedhore Nr.03/2013. Këto zarfe janë në pako kolektive ku pako më e vogël ka brenda 157 zarfe dhe më e madhja pako mban brenda 238 zarfe, këtu pra argumentohet grumbullimi i votave me strukturë unike/identike me një ngjyrë dhe secila ka një pikë të zezë, në mes të fletëvotimit, ku shihet se janë të plotësuar nga një shkrim identik dhe votimi është 100%, për vetëm një parti siç është Lista Serbe, dhe kështu që ne si subjekt politik konsiderojmë se me këto argumente të pa rrëzueshme, kemi të bëjmë me manipulim/votim të një, dy ose grupe personash 100%, për një subjekt politik që qëllim final kanë marrjen e mandatit, për një parti dhe kandidatë në emër të personave jashtë Kosovës që jetojnë në Serbi.

Si provë për pretendimet e tyre parashtruesi i apelit ka bashkangjitur në apel: raportin e Divizionit për Shërbimin e Votuesve të datës 11.10.2019, imazhe që ilustron se si janë dorëzuar paketat me zarfe në Postën numër 6, raporti i KQZ-së, periudha e votimit përmes postës i datës 15.10.2019, deklarata publike e anëtarit të KQZ-së, Sami Hamiti në QNR, i datës 23.10.2019 (me CD), përgjigjen e Postës së Kosovës të datës 04.11.2019, fletëvotime të ilustruara me foto si dhe deklaratat e vëzhguesve të koalicionit NISMA-AKR-PD: Endrit Zabërgja, Taulant Bytyqi, Besnik Bytyqi, Ardian Kelmendi dhe Agon Bytyqi të datës 23.10.2019.

Në përgjigje në apel të datës 08.11.2019, KQZ-ja, ka theksuar se periudha e votimit jashtë Kosovës, ka filluar me datën 19 shtator 2019, dhe ka përfunduar me datën 5 tetor 2019. Përgjatë kësaj periudhe, votuesit që suksesshëm janë regjistruar për të votuar përmes postës (30.08.2019 - 10.09.2019), kanë pasur mundësi që të dërgojnë paketat me fletëvotime përmes postës. Përgjatë periudhës së votimit përmes postës, paketat me fletëvotime janë pranuar nga Qendra Transitore Postare në Fushë Kosovë, dhe nga Posta nr.6, në Prishtinë. Me datën 4 Tetor 2019, në Postën nr.6, në rrugën "Agim Ramadani", Prishtinë janë pranuar 3,782 pako me fletëvotime, nga Serbia. Paketat me fletëvotime sipas objektit të apelit në fjalë janë pranuar me datë 3 dhe 4 tetor 2019. Me 4 tetor 2019, në Postën nr.6, në Prishtinë janë pranuar 3,782 pako me fletëvotime, e që i përkasin votuesve jashtë Kosovës, me vendqëndrim nga Serbia. Ndërsa me datë 3 tetor 2019, në Qendrën Transitore Postare në Fushë Kosovë, janë pranuar 5 zarfe me fletëvotime (ashtu siç është e përshkruar në Raportin e KQZ-së, "Periudha e votimit përmes Postës) i datës 15 tetor 2019. Këto 5 zarfe me fletëvotime, të cilat përmes postës, janë dërguar nga Republika e Maqedonisë së Veriut, përkatësisht nga Shkupi, i përkasin votuesve, të cilët në periudhën e aplikimit për regjistrim kanë shënuar si vendqëndrim në aplikacionin për regjistrim shtetin e Serbisë, por të cilat nuk janë dërguar nga shteti i Serbisë. Ndërkaq, prezantimi në raportin tonë ka qenë reflektim i asaj se çfarë kanë prezantuar votuesit gjatë periudhës së regjistrimit.

Në kërkesën për përgjigje dërguar postës lidhur me informatën rreth shkëmbimit të dërgesave postare nga Serbia në Kosovë dhe anasjelltas, zyrtarja e shitjes znj. Vlora Thaqi Raci përmes email-it, ka dërguar përgjigjen me datë 8.11.2019, duke theksuar se Posta e Kosovës në të gjitha zyrtat postare ku operon në territorin e Republikës së Kosovës pranon letër-dërgesa dhe Kodi Postare edhe për Republikën e Serbisë, të cilat pastaj i dërgon nëpërmjet rrugëve ajrore dhe tokësore, me transit të hapur për këtë shtet. Transitin e hapur Posta e Kosovës e përdor për të gjitha shtetet me të cilat nuk ka këmbim direkt duke shfrytëzuar marrëveshjet me administratë postare të Austrisë dhe të Sllovenisë, në këtë kontest të gjitha dërgesat postare për Republikën e Serbisë, dërgohen nëpërmjet këtyre dy administratave postare, në rrugë ajrore kurse në rrugë tokësore përdorim administratën postare të Maqedonisë.

Të gjitha dërgesat tona të cilat për një arsye nuk dorëzohen në Republikën e Serbisë tek marrësit ato kthehen në të njëjtën rrugë për në Republikën e Kosovës. Sa i përket dërgesave postare të cilat pranohen në Republikën e Serbisë, me destinim Republikën e Kosovës ato trajtohen si dërgesa në trafikun e brendshëm të kësaj administrate postare dhe në Republikën e Kosovës shpërndahen gjerë te marrësi i fundit duke përdorur Qendrën Postare në Graçanicë, si dhe zyrat e tyre postare në enklavat serbe brenda Republikës së Kosovës. Republika e Serbisë nuk ka pranuar shtetin e Republikës së Kosovës, prandaj nuk pranon që të bëjë këmbimin e dërgesave postare sipas rregulloreve të UPU, por i përdor metodat e lartpërmendura dhe kështu i ik detyrimeve terminale të parapara me rregulloret e kësaj organizate.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi apelin, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës konstatohet se me datën 4 tetor 2019, në Postën nr. 6, në Rrugën “Agim Ramadani”, në Prishtinë, janë pranuar 3,782 pako me fletëvotime, të ardhura nga Serbia e të cilat janë dorëzuar në këtë postë nga ana e dy personave. Këto pako me fletëvotime me të njëjtën datë janë pranuar edhe nga KQZ-ja, më pastaj janë proceduar për në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për tu verifikuar dhe proceduar me numërimin. Fletëvotimet brenda këtyre pakove pas verifikimit janë proceduar si të vlefshme ndërsa rezultati i tyre i numërimit është përfshirë në rezultatin përfundimtar, të publikuar me datë 07.11.2019 nga KQZ-ja.

Kontestues është fakti i vlefshmërisë së këtyre pakove të fletëvotimeve sidomos nga aspekti i dërgimit apo pranimin të te njëjtave, përderisa në njërin anë KQZ-ja, i konsideron të vlefshme, pasi thirret se ato janë dorëzuar në “fahun” e veçantë të hapur për pranimin e pakove me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosovës, dhe janë në përputhje me praktikën e KQZ-së, që nga viti 2013, pranimi e pakove me fletëvotime në këtë mënyrë të dërguara nga Serbia. Në anën tjetër ankuesi pretendon se me rastin e pranimin të këtyre pakove me fletëvotime në këtë mënyrë nga ana e KQZ-së, është shkelur Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 97 paragrafi 1, pika a) dhe Rregullës Zgjedhore Nr. 03/2013 neni 4 paragrafi 3.

Me nenin 3 të LZP-së, janë dhënë përkufizimet për emërtimet e përdora në këtë ligj, ku votuesin jashtë Kosovës e përkufizon: *“do të thotë aplikuesi i suksesshëm nga jashtë Kosovës që përdor një nga mënyrat e votimit jashtë territorit të Kosovës, siç është e saktësuar në rregullat e KQZ-së”*.

Rregulla Zgjedhor Nr. 03/2013 në nenin 4 paragrafi 2, përcakton: *“Pas plotësimit të fletëvotimit(eve) votuesi duhet të vendos fletëvotimit(et) në një zarf të pa shënuar e të mbyllur të vendosur brenda zarfit të jashtëm/ për dërgim. Në zarfin e dërgimit votuesi gjithashtu vendosë një fotokopje të dokumentit të tij ose saj të vlefshëm të identifikimit dhe një shënim që përmban të dhënat personale të tij ose saj, dhe që përmban së paku emrin, mbiemrin, emrin e babait dhe datën e lindjes së tij ose saj”*. Ndërsa me nenin 4 paragrafi 3, i të njëjtës rregull zgjedhore përcaktohet: *“Pas plotësimit të fletëvotimit për votim jashtë Kosovës votuesi duhet ta dërgoj atë me postë në njërin nga kutitë postare që ngrihen dhe shpallen publikisht nga KQZ-ja, deri në datën që përcaktohet nga KQZ-ja”*.

Nga dispozitat e cekura më lartë mund të konkludohet se për tu trajtuar i vlefshme një fletëvotim nga jashtë duhet të plotësohen disa kushte: plotësimi i formularit me të dhënat e kërkuara pas shkarkimit të te njëjtit, dërgimi i të njëjtit me të dhënat e dërguara në adresën postare të “fahut postal” të shpallur publikisht nga KQZ-ja. Në rastin konkret për shkak të kontestimit të mënyrës së dërgimit, Paneli nuk do të lëshohet në aspektin e mënyrës së

plotësimit apo aspekteve tjera. Pakot e fletëvotimeve nga Serbia, janë dorëzuar fizikisht drejtpërdrejt në “fahun postal” nga persona të caktuar, pra nuk kemi dërgim por dorëzim, gjë që në rastin konkret nuk është plotësuar kushti i dërgimit, pasi nuk kemi postën dërguese por vetëm atë pranuese. Duke marrë për bazë që pakot me fletëvotime kanë arritur në postës pranuese fizikisht pa vulë të postës dërguese dhe pa pullë postare, të njëjta nuk mund të kategorizohen si fletëvotime nga jashtë dhe rrjedhimisht të tillat në bazë të rregullave në fuqi konsiderohen të pa vlefshme. Kur kësaj rrethane i shtojmë edhe faktin se votat janë dorëzuar në Postën Nr. 6, në Rrugën “Agim Ramadani”, në Prishtinë, nga dy persona njëri nga të cilët i pa identifikuar, për të cilët KQZ-ja, është deklaruar se nuk janë të autorizuar. Po ashtu fakti se si kanë arritur që të gjitha pakot me fletëvotime të grumbullohen në një vend të caktuar dhe të sillen nga dy persona e bën edhe ma të pa besueshëm procesin e votimit me post që në fakt më këtë rast nuk kemi votim përmes postës, por dorëzim fizik në postë. Ky fakt provohet edhe nga përgjigja e dhënë nga Posta e Kosovës, me Nr.05-2264/19 e datës 04.11.2019, në të cilën konstatohet: *“Se pakot me zarfe janë dorëzuar në zyrën Nr. 6 me datë 04.11.2019, nga personi që është prezantuar si Dejan Paviqeviq, me një person i cili nuk është prezantuar, pakot ishin vendosur ne kuti A4, ku brenda kutive ishin se paku nga 20 zarfe sipas numrit tonë ishin 3782 copa. Zarfet në grumbull nga Serbia, brenda kutive kanë qenë me ngjyrë të bardh dhe pa vulë postare të Origjinës nga Serbia, zyrtaret e postës edhe pse nuk kish vulë postare të origjinës sipas adresës së dërguesit i kanë vulosur dhe regjistruar në librat e pranimit. Për dallim nga dërgesat e rregullta nga vendet e tjera të botës të cilat kanë ardhur si dërgesa REKOMANDE R, dërgesa të thjeshta dhe komerciale me vulën postare të origjinës dhe sipas adresave të dërguesit në adresë të destinimit pakot nga Serbia nuk janë pranuar në formë të rregullt që Posta e Kosovës i pranon nga shtete tjera”* këtë nuk e ka konstatuar as KQZ-ja, në përgjigjen e dhënë.

Paneli, ka vlerësuar pretendimet nga përgjigja e KQZ-së, se në kuadër të këtij organi është krijuar një praktikë e tillë e mëhershme e pranimit të këtyre pakove me fletëvotime, ku fillimisht këto pako janë dorëzuar përmes OSBE-së, mirëpo ky pretendim dhe praktikat që kanë qenë në kundërshtim me ligjin dhe rregullat zgjedhore, nuk e obligojnë Panelin, në raport me vendimmarrjen në rastin konkret. Në të kaluarën pranë PZAP-it, nuk ka pasur rast kur fletëvotimet që nuk janë dorëzuar në përputhje me ligji dhe rregullën zgjedhore janë pranuar si të vlefshme dhe të njëjtat janë atakuar tek PZAP-i, po ashtu PZAP-i, për secilin rast vendos në mënyrë të veçantë pasi rastet janë individuale.

Dispozitat ligjore të LZP-së, kanë përcaktuar procedurat në bazë të cilave çdo qytetar mund ta ushtroj të drejtën e vet kushtetuese për të u zgjedhur dhe për të zgjedhur, dhe çdo anashkalim i zbatimit të këtyre dispozitave nënkupton cenim i procesit të rregullt zgjedhor, dhe me këtë cenim i të drejtave të qytetarëve, edhe atyre që kanë qenë në këtë proces zgjedhor si kandidat për tu zgjedhur, si dhe votuesve të cilët ju janë përmbajtur rregullave të dispozitave ligjore për t’i ushtruar të drejtat e tyre.

Paneli, ka marrë parasysh edhe rrethanën nëse cenohet ndonjë e drejtë kushtetuese votuesve të 3782 (tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy) pakove me fletëvotime të ardhura nga Serbia të dorëzuara në postën Nr. 6, në Prishtinë, të anuluar si në dispozitiv të këtij vendimi, por vlerëson se këta qytetar kanë pasur mundësinë që të votojnë sikur edhe çdo qytetar-votues jashtë vendit, për të vërtetuar këtë fakt nga Republika e Serbisë, kanë ardhur 5 pako, me fletëvotime të dërguara përmes postës në procedurë të rregullt, e të cilat kanë arritur përmes Maqedonisë së Veriut, ashtu siç edhe e ka përkshkruar si njërën nga mundësit e rregullta, Posta e Kosovës, në përgjigjen e dhënë sipas kërkesës së Panelit, gjë që e njëjta rrugë ka pasur mundësi të shfrytëzohet edhe në rastin e këtyre pakove me fletëvotime, nga të gjithë qytetarët e Kosovës, me të drejtë vote të cilët kanë vendqëndrim në Republikën e Serbisë. Vetë fakti i përmendur nga Posta e Kosovës se Republika e Serbisë, pasi nuk e

pranon shtetësinë e Republikës së Kosovës dhe më këtë edhe komunikimin direkt përmes Postës së dy shteteve, nuk do të thotë se në këtë rast pakot me fletëvotime të ardhura nga Republika e Serbisë, duhet kenë tretman te ndryshëm dhe jo ligjor, siç janë pranuar në këtë rast nga KQZ-ja, dhe janë procesuar të njëjtat.

Andaj duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e këtij rasti, mënyra si janë grumbulluar pakot me fletëvotime, mënyra e dorëzimit të tyre direkt në fahun postal të KQZ-së, nga persona të pa autorizuar, më shumë i ngjason votimit kolektiv, i cili cenon dhe minon rënd integritetin e procesit zgjedhor, që është në kundërshtim me dispozitat ligjore, si dhe rekomandimet e Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) Kodi i Praktikës së Mirë në çështjet zgjedhore i miratuar me datë: 18-19 tetor 2002, të cilat parashohin: “Votimi me postë mund të lejohet vetëm në qoftë se shërbimi postar është i sigurt, nuk ka ndërhyrje të qëllimshme- dhe i besueshëm, në kuptimin që funksionon siç duhet, ndërsa votimi me anë të tretëve është i lejueshëm vetëm në qoftë se i nënshtrohet rregullave stërkitë, përsëri me qëllim që të parandalohet mashtrimi, numri i prokurave që mund të ketë një zgjedhës duhet të jetë i kufizuar”, që do të thotë se pranimi i këtyre pakove dhe i fletëvotimeve si të rregullta nuk është as konform këtyre rekomandimeve, ndërsa votimi përmes të autorizuarve apo personave të tretë në legjislacionin tonë nuk është paraparë si mundësi ligjore.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lart e në kuptim të nenit 115 paragrafi 1, neni 117 paragrafët 2 dhe 3, neni 119 paragrafi 5, neni 120 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.428/2019 më datë 10.11.2019

Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi lejohet ankesa, brenda afatit 24 orë nga dita e pranimit, në Gjykatën Supreme.